

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mesatarisht 34 mijë lekë për një fëmijë/ Sa shtrenjtë kushton dita e parë e shkollës në Shqipëri?! Çmimet për “shportën” arsimore
ADRESA	https://albeu.com/lajme/mesatarisht-34-mije-leke-per-nje-femije-sa-shtrenjte-kushton-dita-e-e-pare-e-shkolles-ne-shqiperi-cmimet-per-shporten-arsimore/1010382/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:52:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 06:47:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1596b8e9280b5b84a579d2aafdd92688e18567bd868155974fed7c697287caa8
TEKSTI	a8794d0f18a2409bf08dc5d730ba697ddc314e5198e40b073677b3d4d1d0e7dc
PAMJA	a79d4f2927f325dc5af0229c394c553d452b6714fbfcb82d89fa1e8d7a036247

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1875f3df7a9cf9045d4af23c3709c31e5e7628836584ea4fc2ed8d1354a4f572
E MËPARSHMJA	9c38eea0cda09ee6480878bd2721ec3af7f0d90b1186d8600fbbe01aacbef757
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1875f3df7a9cf9045d4af23c3709c31e5e7628836584ea4fc2ed8d1354a4f572>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mesatarisht 34 mijë lekë për një fëmijë/ Sa shtrenjtë kushton dita e parë e shkollës në Shqipëri?! Çmimet për “shportën” arsimore



Rikthimi në shkollë ka një paradoks: arsimit publik është falas, por hyrja në të nuk është. Një vërtetim i çmimeve në Tiranë tregon se, nëse një familje duhet të blejë nga e para çantën, kancelaritë, atletet dhe një garderobë bazë, shporta e shtatorit mund të arrijë rreth 37,200 lekë për një fëmijë. Për dy ose më shumë fëmijë, fatura bëhet e kripur...

Shtatori ka një mënyrë të vetën për t'i bërë shpenzimet e vogla të duken të mëdha. Një fletore kushton pak. Një laps po ashtu. Edhe një bluzë, e marrë veçmas, nuk duket si një goditje për buxhetin.

Por shkolla nuk nis me një fletore, një laps apo një bluzë. Ajo nis me një listë. Dhe listat kanë zakonet e pakëndshëm që, kur mbledhen, të prodhojnë një shifër krejt tjetër nga ajo që prindi kishte në mendje kur hyri në dyqan.

Në të njëjtën shportë përfundojnë fletoret, stilolapsat, lapsat me ngjyra, vizoret, kutia e lapsave, materialet e vizatimit, mbështjellëset e librave dhe dhjetëra artikuj të tjerë që kushtojnë nga disa dhjetëra deri në disa qindra lekë secili.

Pastaj vjen çanta, zakonisht një nga blerjet më të mëdha të fillimvitit. Pas saj atletet, pantallonat, bluzat, veshjet sportive dhe, sipas shkollës, uniforma.

Dhe kjo është vetëm dita e parë. Rikthimi në shkollë nuk është një shpenzim i vetëm, por fillimi i një serie të vogël pagesash që vazhdojnë edhe pasi ka rënë zilia e parë.

Një material që mësuesi e kërkon më vonë, një fletore tjetër, fotokopje, mjete për një projekt, një palë atlete që duhen vetëm për fizikulturë apo një veshje që mungonte në blerjet e para.

të fundit /



Nis viti i ri shkollor, Presidenti Begaj uron nxënësit: Besoni te...



Mesatarisht 34 mijë lekë për një fëmijë/ Sa shtrenjtë kushton dita...



Kryeministri Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor: Institucionet...



Kurti paralajmëron para vendimit për ish-udhëheqësit e UÇK-s...



Pjesa më e vështirë e autostradës Kërçovë - Ohër do të hapet për...



Nisin aplikimet për konvikte dhe mensën e studentëve në Prishtinë...



Alket Rizai përshihet në përplasje me a'më në Greqi, policia vihet...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Në familjet ku ka dy apo tre fëmijë, këto shpenzime nuk shumëzohen gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse disa gjëra mund të trashëgohen nga njëri fëmijë te tjetri, por presioni mbi buxhetin rritet ndjeshëm.

Për një familje që mund të ripërdorë çantën e vitit të kaluar, të blejë vetëm disa rroba ose të presë uljet, kostoja mund të jetë dukshëm më e ulët.

Për një tjetër, ku fëmija ka ndryshuar masën e këmbës, çanta është konsumuar dhe garderoba duhet rifreskuar, shtatori nis praktikisht nga zero. Kështu, kostoja e shkollës nuk përcaktohet vetëm nga çmimi i artikujve, por shpesh edhe nga ekonomia e ripërdorimit.

Çanta nuk është më një çantë

Në tregun e artikujve shkollorë, diferenca mes asaj që është e nevojshme dhe asaj që duam, mund të matet me disa mijëra lekë. Çanta është ndoshta shembulli më i qartë. Modelet e shkollës të publikuara online lëvizin rreth 1,200–3,000 lekë.

Te një tjetër dyqan diapazoni zgjerohet, nga rreth 2,900 lekë për disa modele deri në 10,900–11,800 lekë për çanta me rrota apo modele të licencuara. Një çantë Seven e publikuar nga kancelarite e Tiranës kushton 6,990 lekë. Për përlogaritjen tonë kemi marrë 6,000 lekë si çmim orientues, një nivel që qëndron mes alternativave ekonomike dhe produkteve më të shtrenjta.

Hapësira e madhe mes 1,200 dhe afro 12 mijë lekëve tregon se çanta e shkollës nuk është më një produkt me një funksion dhe një çmim të përafërt. Në të njëjtën kategori tregtohen produkte që u drejtohen buxheteve dhe kërkesave krejt të ndryshme. Një familje mund ta zgjidhë këtë pjesë të listës me më pak se 2 mijë lekë, ndërsa një tjetër mund të shpenzojë pesë ose gjashtë herë më shumë vetëm për çantën.

Çmimi ndryshon sipas materialit, përmasave, ndarjeve të brendshme, strukturës ergonomike, pranisë së rrotave dhe aksesorëve shtesë. Por jo vetëm. Një pjesë e diferencës lidhet me markën dhe licencën. Personazhet e filmave dhe animacioneve, klubet sportive apo markat e njohura e zhvendosin produktin nga kategoria e një mjeti të zakonshëm shkollor drejt një artikulli ku paguhet edhe dizajni dhe emri.

Kjo ka ndryshuar edhe mënyrën se si blihet çanta. Për prindin, kriteret mund të jenë pesha, rezistenca dhe mundësia që të përdoret për më shumë se një vit. Për fëmijën, vendimi mund të nisë nga një kriter krejt tjetër: personazhi, ngjyra, modeli apo ajo që kanë zgjedhur bashkëmoshatarët. Në pikën ku takohen këto dy kërkesa përcaktohet edhe sa do të shpenzohet.

Për familjen, zgjedhja ka edhe një llogari tjetër: sa vite do të përdoret. Një çantë prej 6,000 apo 7,000 lekësh që reziston dy ose tre vite mund të rezultojë më ekonomike sesa një model më i lirë që duhet zëvendësuar çdo shtator. Por kjo llogari funksionon vetëm nëse çanta nuk bëhet e vogël, nuk dëmtohet dhe, ndoshta më e rëndësishmja për fëmijët, vazhdon t'u pëlqejë edhe vitin tjetër.

Fletoret janë të lira. Shporta jo

Kancelaritë janë shembulli më i mirë i aritmetikës së shtatorit. Një fletore 32-fletëshe kushton nga 25 lekë deri në 150 lekë, në varësi të cilësisë së fletës dhe cilësisë së kapakut. Kuletat e mjeteve shfaqen rreth 1000-2500 lekë, ndërsa paketa me lapsa apo stilolapsa mund të kushtojë nga disa qindra lekë deri në rreth 1,200 lekë, sipas modelit dhe markës.

Pastaj vijnë ngjyrat, vizoret, kompasit, mprehesja, goma, ngjitësi, gërrshërët, fletorja e vizatimit. Secili zë duket i parëndësishëm. Së bashku, jo. Në shportën orientuese të "Monitor", kancelaria dhe materialet bazë llogariten në rreth 11000 lekë. Kur shtohen elementë të tjerë, rritet pesha e pagesës së prindërve për një fëmijë.

Por, pjesa më e shtrenjtë e kthimit në shkollë mund të mos jetë fare ajo që futet në çantë. Është ajo që vishet. Një vrojtim te shitësit e veshjeve dhe këpucëve sportive tregon se një bluzë për fëmijë shitet shpesh rreth 1,500-3,600 lekë, ndërsa një palë atlete për fëmijë lëvizin gjerësisht: nga rreth 3,600 lekë për modele Champion, në 5,500-7,900 lekë për modele Nike dhe deri në 10,900 lekë për disa modele të segmentit më të lartë. Për adoleshentët, kostoja përfshin lehtësisht atlete 6,500-10,900 lekë.

Dy fëmijë? Një problem tjetër

Për një familje që nuk ka nevojë të zëvendësojë çantën, atletet apo të gjithë garderobën, fatura mund të jetë dukshëm më e ulët. Pikërisht kjo është arsyeja pse 34,200 lekët nuk duhen lexuar si një shumë që çdo prind do ta paguajë. Ato tregojnë se sa kushton një "reset" relativisht i plotë për fillimin e shkollës, me produkte të segmentit të mesëm.

Për dy fëmijë, e njëjta shportë tejkalon 60 mijë lekë, pra është më shumë se sa një pagë minimale. Po ta krahasojmë me pagën mesatare në vendin tonë, e cila sipas INSTAT është 90.119 lekë, shporta për një fëmijë është ekuivalente me rreth 38% të pagës mesatare; për dy fëmijë, pesha arrin në rreth 76% të saj.

Mënyra më e drejtpërdrejtë për të ulur faturën e shtatorit mbetet ripërdorimi: një çantë, një palë atlete apo veshjet që mund të përdoren edhe një vit tjetër mund ta ulin ndjeshëm shportën. Ndërsa familjet përpiqen të blejnë vetëm atë që duhet zëvendësuar, për tregtarët "Back to School" është një nga sezonet e konsumit, ku ofertat, setet dhe produktet e licencuara synojnë ta zgjerojnë listën përtej nevojave bazë./ Monitor

Zëri	Sasia	Çmimi orientues (lekë)
Çantë shkolle	1	6,000
Kuti/kuletë lapsash	1	1,500
Fletore	10 copë	1,000

Lapsa dhe stilolapsa	1 set	1,200
Ngjyra, vizore, kompas, mjete të tjera	1 set	2,000
Shishe uji + kuti ushqimi	1 set	2,500
Atlete	1 palë	5000
Bluza	2 copë	4,000
Pantallona/xhinse	1 palë	3,500
Veshje sportive/tuta	1 komplet	3,500
Felpa/xhup i hollë	1	4,000
TOTALI		34,200

Shënim/ Shporta është një përlogaritje, jo statistikë zyrtare. Çmimet janë rishikuar më 11 shtator 2026 nga oferta të publikuara online në Tiranë dhe vëzhgime dyqanesh. Për artikujt me gamë të gjerë çmimesh është përdorur një vlerë përfaqësuese e segmentit të mesëm, jo mesatarja aritmetike e gjithë tregut. Totali supozon se artikujt kryesorë blihen nga e para; familjet që ripërdorin çantën, veshjet ose këpucët do të kenë një faturë më të ulët. Nuk llogariten librat, që për pjesën më të madhe të familjeve janë kosto e lartë.

Shtuar më 14.09.2026 08:47

Tags: [cmimet](#), [dita e pare e shkolles](#)



Nis viti i ri shkollor, Presidenti Begaj uron nxënësit: Besoni te vetja...



Këmbimi valutor 14 Shtator 2026/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë...



Horoskopi 14 Shtator 2026/ Njihuni me surprizat e yjeve për secilën shenjë



A rrezikojnë shqiptarët dëbimin nga Gjermania? Deputeti i AfD-së, Tobias...



Patos, një person gjendet pa shenja jete në oborrin e banesës



Përplasje me armë në Anavyssos, Alket Rizai në kërkim para rikthimit të...



LVV dhe LDK dakord për një kandidat konsensual për presidentin, Kraki: Së...



Pas fjalimeve, protestuesit nisin marshimin në bulevardet e Tiranës



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.